

Raport i anketimit për klimën e biznesit dhe investimeve në Kosovë 2023

Rezultatet e sondazhit të 9. të OEGJK



Raport i anketimit për klimën e biznesit dhe investimeve në Kosovë 2023

Rezultatet e sondazhit të
Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare

Situata ekonomike, pritshmëritë dhe
klima e të bërit biznes në Kosovë

Impressum

© 2023 Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Grumbullimi dhe vlerësimi i të dhënave nga shtetet pjesëmarrëse:

Oda Ekonomike Gjermano-Hungareze

Autore për raportin e Kosovës: Nora Hasani, Drejtoreshë Menaxhuese e OEGJK-së dhe Sytrime Dervisholli, Udhëheqëse e Departamentit për Avokim dhe Marrëdhënie me Qeverinë në OEGJK, Dimal Hoti dhe Jon Gärvalla.

Përmbajtja e këtij raporti mund të shfrytëzohet falas duke deklaruar "Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare në Kosovë" si burim; kërkohet sjellja e një kopje të informatave të përdorura. Informatat mbi raportin janë hartuar me kujdes maksimal. Megjithatë, OEGJK nuk merr asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informatave. OEGJK përjashton të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rrjedhin nga përdorimi i informatave të ofruara.

Kontakt: info@oegjk.org

Tel.: +383 38 600 880

Parathënie

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) publikoi anketën e saj të 9-të për klimën e të bërit biznes dhe të investimeve në Kosovë. Ky sondazh përmban vlerësime të kompanive tona anëtare, që janë kryesisht kompani gjermane apo kompani vendore që kanë marrëdhënie tregtare me Gjermaninë si dhe investitorëve të tjerë të huaj mbi situatën ekonomike dhe klimën e investimeve në Kosovë.

Që nga viti 2006, kjo anketë e cila në gjermanisht njihet si AHK Konjunkturumfrage, zhvillohet njëkohësisht në mënyrë të koordinuar nga Dhomat Gjermane të Tregtisë dhe Industrisë në Evropën e Mesme dhe Lindore. Sivjet ekonomitë e 16 shteteve ishin në krahasim. Gjithsej 1620 udhëheqës të kompanive nga këto vende morën pjesë në anketim.

Prandaj anketa vjetore e Odave Ekonomike Gjermane, ofron një bazë të mirë krahasuese ndërmjet ekonomive të shteteve pjesëmarrëse. Përmes saj OEGJK nuk synon të ofrojë një vjetar statistikor, por të vlerësojë faktorët që janë të rëndësishëm për të bërit biznes në Kosovë, dhe të paraqes gjendjen e bizneseve pjesëmarrëse në anketë, në periudhën e anketimit.

Sondazhi është një instrument shumë i mirë për të vlerësuar situatën ekonomike në Kosovë, për të kuptuar kërkesat e kompanive por edhe pritjet që kanë për të bërit biznes me Gjermaninë në të ardhmen, dhe të njejtat t'i marrim parasysh për rekomandimet tona karshi qeverisë.

OEGJK nga rezultatet e sondazhit mëson se ku mund të mbështes ekonominë e Kosovës më tutje, dhe kompanitë anëtare në veçanti. Rezultatet gjithashtu do të jenë në shërbim të qeverisë së Kosovës për të hartuar politika më të mira ekonomike dhe për të ofruar korniza më të mira për lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë.

Sondazhi i Odave Ekonomike Gjermane konsiderohet si barometër i rëndësishëm për të vlerësuar situatën dhe pritjet e kompanive dhe, duke u bazuar në këndvështrimin e tyre, gjithashtu mundëson edhe krahasimin e kushteve për investim ndërmjet këtyre 16 vende. Dy vite pas shpërthimit global të koronavirusit dhe disa muaj nga pushtimi rus i Ukrainës, që shkaktojë vështirësi të mëdha dhe humbje ekonomike të papara për ekonominë globale dhe atë kosovare, përmes rezultateve të anketës sonë shohim që ka një optimizëm tek bizneset pjesëmarrëse dhe ka pritje pozitive për kohën pas pandemisë.

Për të ndihmuar në kalimin e kësaj shtate të vështirë, si dhe për të bërë Kosovën një vend më të mirë për të jetuar dhe për të bërë biznes, OEGJK do të vazhdojë punën intensive në përkrahjen e bizneseve gjermane në Kosovë dhe kompanive anëtare.

Kosovën e pret një perspektivë shumë pozitive për të ardhmen, nëse të gjithë japim kontributin tonë.

Përmbajtja

Raport i anketimit	3
Rezultatet e sondazhit të	3
Situata ekonomike, pritshmëritë dhe klima e të bërit biznes në Kosovë	3
Impressum	4
Parathënie	5
Përmbajtja	6
Përmbledhje ekzekutive	7
1. Vlerësimi i situatës ekonomike	9
2. Punësimi dhe Investimet	14
3. Vlerësimi i faktorëve të të bërit biznes	16
4. A do të zgjidhni Kosovën përsërisi një vend për të investuar?	22
5. Lufta në Ukrainë	24
SHTOJCA	27
A. Pyetjet	27
B. Metodika	31
C. Pjesëmarrësit	31
D. SHKURTESAT	32

Përmbledhje ekzekutive

Rreth anketës

- Kompanitë anëtare të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare për të 9 herë me radhë marrin pjesë në anketën e përvitshme të Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK) në Rajonin e Evropës së Mesme dhe Lindore. Këtë vit 103 udhëheqës të kompanive kosovare u janë përgjigjur pyetjeve tona, ku pjesëmarrësit janë kryesisht kompani gjermane dhe kompani të orientuara nga eksporti.
- Paralelisht me sondazhin kosovar, është kryer një studim i ngjashëm në 15 vende të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, i cili mundëson krahasime ndërkombëtare të këtyre 16 shteteve.
- Në raport mund të gjeni dhe rezultatet e sondazhit për vitin 2022 në krahasim.

Situata aktuale ekonomike

Në vitin 2023, ekonomia e Kosovës u rikthye plotësisht në gjendjen e saj të mëparshme. Megjithatë, kjo rimëkëmbje u pengua nga lufta në Ukrainë e cila shkaktoi tronditje edhe në ekonominë e Kosovës. Shumica e kompanive të anketuara parashikojnë që ekonomia do të zhvillohet pozitivisht, jo vetëm në përgjithësi, por edhe në raport me bizneset e tyre. Rreth 57% e të anketuarve pritet të shohin përmirësim të situatës në fushën e tyre brenda 12 muajve të ardhshëm, ndërsa 12% parashikojnë që situata do të përkeqësohet.

Punësimi dhe investimet

Pavarësisht sfidave që kanë ndodhur si pasojë e pandemisë dhe luftës në Ukrainë, kompanitë e anketuara tregojnë një qëndrim pozitiv dhe janë të gatshme të ndërmarrin rreziqe për të rritur punësimin dhe investimet në bizneset e tyre. Në lidhje me punësimin, 58% e të anketuarve presin një nivel më të lartë punësimi krahasuar me vitin 2022, ndërsa 35% nuk kanë plane për të reduktuar vendet e punës dhe 7% planifikojnë t'i reduktojnë vendet e punës. Në lidhje me investimet, 66% e të anketuarve synojnë të rrisin investimet në bizneset e tyre, ndërsa 28% nuk kanë plane për të rritur investimet dhe 6% planifikojnë të ulin investimet në bizneset e tyre.

Kriza e shkaktuar nga lufta në Ukrainë

Gjatë periudhës së anketimit, vetëm 11% e kompanive të anketuara kanë deklaruar se lufta në Ukrainë nuk do të ketë pasojë afatshkurtra ose afatgjata për kompaninë e tyre. Ndërsa, 73% e kompanive të anketuara kanë theksuar se rritja e kostove paraqet një pengesë për ta; 27% e kompanive të anketuara besojnë se mungesa e inputeve do të ndikojë në funksionimin normal të kompanisë së tyre, ndërsa 33% e kompanive të anketuara kanë theksuar se pengesat ose ndërprerjet në zinxhirin e furnizimit paraqesin një pengesë për kompaninë e tyre.

Mungesë e punëtorëve të kualifikuar

Udhëheqësit e kompanive të anketuara ankohen për mungesën e fuqisë punëtore, vetëm 11% janë të kënaqur me disponueshmërinë e punëtorëve të kualifikuar, ndërsa mbi 33% janë të pakënaqur me situatën aktuale. Për të arritur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, duhet të investohet më shumë në arsimin profesional.

Kërkohet veprim në drejtim të përmirësimeve nga ana e qeverisë kosovare

Në pyetësor vlerësohen nga të anketuarit 21 faktorë të cilët përcaktojnë cilësinë e vendit si destinacion investimesh, dhe vihet re se për shumë prej tyre ka nevojë për përmirësime. Nga njëra anë, 19% e kompanive janë të kënaqura me efikasitetin e administratës publike, ndërsa 18% janë të pakënaqur. Në anën tjetër, vetëm 15% e kompanive të anketuara janë të kënaqura me qasjen në subvencionet publike, ndërsa 31% e tyre janë të pakënaqur.

Kërkohet luftimi i korrupsionit dhe përmirësimi i infrastrukturës

Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë veprime, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe kriminalitetit. Përveç luftës kundër korrupsionit dhe transparencës, përmirësimi i infrastrukturës (transporti, komunikimi, energjia), përmirësimi i cilësisë së sistemit të arsimit profesional dhe disponueshmëria e punëtorëve të kualifikuar janë detyrat më të rëndësishme të qeverisë.

Kosova në krahasim me rajonin e Evropës së Mesme dhe Lindore

Rezultatet e anketimit në Kosovë në krahasim me rajonin paraqesin një qëndrim relativisht të mirë të bizneseve për sa i përket gjendjes dhe zhvillimit ekonomik.

Besnikëria ndaj Kosovës: 85% do të investonin përsëri në Kosovë

85% e të anketuarve kanë deklaruar që do të investonin dhe sot në Kosovë ndërsa 15% nuk do të investonin përsëri në Kosovë.

1. Vlerësimi i situatës ekonomike


Lufta në Ukrainë, dhe rritja e çmimeve të energjisë, si dhe ngadalësimi i rritjes globale, po rëndojnë performancën ekonomike të Kosovës dhe në përgjithësi të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Çmimet e larta të energjisë dhe produkteve ushqimore e kanë shtyrë inflacionin në nivele të papara për shumë vite. Sidoqoftë, tashmë po shihet një trend rritës në të dhënat e viteve të kaluara. Ekonomia po jep indikacione se po vazhdon të stabilizohet, megjithëse çmimet janë ende të larta dhe nuk është kthyer ende në normalitetin e vjetër. Nga ky sondazh, shihet se çdo i treti vlerëson situatën ekonomike si jo të mirë. Megjithatë, bizneset në Kosovë presin zhvillime pozitive në 12 muajt e ardhshëm. 57 përqind presin një përmirësim të situatës në sektorin e tyre brenda 12 muajve të ardhshëm, ndërsa 12 përqind janë të brengosur për përkeqësim të situatës.

Rezultatet e sondazhit në detaj

1.1 Si e vlerësoni gjendjen aktuale të ekonomisë në shtetin tuaj?

Anketa e këtij viti tregon se situata ekonomike në Kosovë është perceptuar në përgjithësi më mirë nga bizneset se sa në vitin e kaluar: 23% e vlerësojnë situatën si "e mirë", 43% si "të pandryshueshëm" dhe 34% si "e keqe".


Gjendja aktuale e ekonomisë



1.2 Si e vlerësoni perspektivën e ekonomisë së shtetit tuaj këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar?

Pritshmëritë ekonomike për ekonominë kosovare po përmirësohen edhe këtë vit. Kështu, 39% e kompanive të anketuara vazhdojnë të besojnë se situata do të përmirësohet më tej, 44% besojnë se situata do të mbetet pa ndryshim, ndërsa vetëm 17% presin një përkeqësim.


Pritshmëritë për situatën ekonomike



1.3 Si e vlerësoni situatën aktuale në industrinë tuaj?

Situata aktuale e industrive të ndryshme shihet si pozitive nga kompanitë e anketuara, edhe përkundër ndikimeve të vazhdueshme të luftës në Ukrainë. Ndërsa në vitin e kaluar 2022 vetëm 31% e raportuan se situata në industrinë e tyre ishte e mirë, në vitin 2023 është 38%. Gjithashtu, numri i kompanive që raportuan se situata ishte pa ndryshim, u rrit. Vetëm numri i kompanive që vlerësonin situatën aktuale si të keqe u ul nga 31% (2022) në 15% në vitin 2023.


Gjendja aktuale në industrinë tuaj



1.4 Si do të zhvillohet situata në industrinë tuaj këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar?

Si përgjigje në pyetjen: "Si do të zhvillohet gjendja në industrinë tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?", 57% e kompanive të anketuara u përgjigjën se ata presin një përmirësim, ndërsa 31% ishin neutral dhe 12% pritnin një përkeqësim.


Gjendja në industrinë tuaj në vitin vijues



1.5 Si e vlerësoni situatën aktuale ekonomike të ndërmarrjes tuaj?

Në lidhje me situatën aktuale ekonomike të biznesit të tyre, vërehet një trend gati i njëjtë në krahasim me vitin e kaluar. Gjendja e përgjithshme vlerësohet si më e mirë në përgjithësi.


Gjendja aktuale ekonomike e ndërmarrjes tuaj



1.6 Si do të zhvillohet situata ekonomike e ndërmarrjes tuaj këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar?

Pritshmëritë e kompanive të anketuara në lidhje me zhvillimet në sektorin e tyre krahasuar me vitin e kaluar, janë përmirësuar dukshëm. 67% e kompanive tregojnë në vitin 2023 pritshmëritë e tyre janë për një përmirësim të situatës ekonomike në sektorin e tyre. Si në vitin e kaluar, 26% thanë se situata do të mbetet e pandryshuar, ndërsa vetëm 7% pritnin një përkeqësim të saj.

Gjendja ekonomike e ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues




12

1.7 Si do të zhvillohen shitjet tuaja totale në këtë vit në krahasim me vitin e kaluar?

Grafiku tregon se kompanitë janë pozitive në lidhje me pritshmëritë e tyre për shitjet. Më shumë se dy të tretat presin një rritje.


Zhvillimi i shitjeve totale në krahasim me vitin e kaluar



1.8 Si do të zhvillohen shitjet tuaja të eksportit gjatë këtij viti në krahasim me vitin e kaluar?

Po ashtu, ka një tendencë në rritje në lidhje me eksportin. 50% e kompanive të anketuara presin një rritje, 42% nuk presin ndryshim, dhe vetëm 8% presin që eksporti i tyre të ketë rënie.

Zhvillimi i të ardhurave nga eksporti gjatë këtij viti në krahasim me vitin e kaluar




2. Punësimi dhe Investimet

Pavarësisht vështirësive të ekonomisë botërore sot, veçanërisht luftës në Ukrainë dhe normave të larta të inflacionit të lidhur me të, rezultate pozitive janë vërejtur në sondazhin e këtij viti. Ka kompani të gatshme të ndjekin një qasje më proaktive dhe të marrin vendime strategjike, megjithëse ka rritje të kostove të jetesës në përgjithësi.

1.1 Si do të zhvillohet numri i të punësuarve në ndërmarrjen tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?

Siç mund të vlerësohet nga grafikoni, 58 % e bizneseve planifikojnë që të rrisin numrin e të punësuarve dhe ky është një sinjal pozitiv, që përkundër situatës ekonomike globale, bizneset do të rrisin kapacitetet e burimeve njerëzore.


Numri i të punësuarve në ndërmarrjen tuaj në vitin vijues



1.2 Si do të zhvillohen shpenzimet investive të ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues, krahasuar me vitin paraprak?

Siç mund të shihet nga grafikoni, bizneset shfaqin gatishmëri për të investuar në kompanitë e tyre, përkundër pasigurisë ekonomike në nivel global, më konkretisht 66% e bizneseve janë të gatshme të investojnë.

Shpenzimet investive të ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues



1.3 Në çfarë përqindje pritet të rriten shpenzimet tuaja për paga gjatë këtij viti (për punonjës, duke marrë parasysh lehtësimin e qeverisë)?

Pritet një rritje e shpenzimeve për paga prej 18% në vitin 2023.


Një rritje e shpenzimeve për paga prej 18% gjatë këtij viti do të thotë një rritje e ndjeshme e shpenzimeve për kostot e personelit. Kjo mund të ndikojë në rentabilitetin e një kompanie dhe mund të kërkojë përshtatje në buxhetim dhe planifikim të burimeve. Për të minimizuar ndikimin, kompanitë mund të ndërmarrin masa të ndryshme si p.sh. rishikimin e proceseve dhe rrjedhës së punës, optimizimin e proceseve të punës, zvogëlimin e punës shtesë ose rritjen e produktivitetit. Një monitorim i kujdesshëm i shpenzimeve për paga dhe një përshtatje e hershme e strategjisë së biznesit mund të ndihmojë në sigurimin e suksesit afatgjatë të kompanisë.

3. Vlerësimi i faktorëve të të bërit biznes


Kompanitë e anketuara rreth kushteve/faktorëve të të bërit biznes në vend janë të mendimit që ashtu si më parë, ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm në fushën e administratës publike, qasjen në subvencionet publike, luftimin e korrupsionit dhe kriminalitetit, infrastrukturën fizike dhe aftësimin profesional.

Këto janë ndër fushat kryesore në të cilat ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme të qeverisë.


Administrata publike




Qasja në subvencionet publike




Luftimi i korrupsionit dhe kriminalitetit




Infrastruktura (transporti, TIK, energjia)




Cilësia e sistemit të aftësisit profesional




Disponueshmëria e punonjësve të kualifikuar




Në përgjithësi, si e vlerësoni punën e qeverisë aktuale?




Cili është ndikimi i granteve nga fondet e BE-së në vendimmarrjen tuaj për investime?




Ku i shihni rreziqet më të mëdha në zhvillimin ekonomik të kompanisë tuaj në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm?



Cilat masa keni ndërmarrë ose planifikoni të ndërmerrni në të ardhmen për të zbutur pasojat e mungesës së punëtorëve të kualifikuar?



Kur prisni që zingjirët ndërkombëtar të furnizimit të normalizohen në një masë të madhe?



4. A do të zgjidhni Kosovën përsëri si një vend për të investuar?

85% e të anketuarve do të zgjidhnin Kosovën përsëri si një vend për të investuar, 3% më shumë se në vitin 2022.

Mesatarja e rezultateve të Evropës së Mesme dhe Lindore në këtë aspekt është 85%.

	SHTETI	2022		2023	
		PO	JO	PO	JO
1	Estonia	100%	0%	100%	0%
2	Lituania	96%	4%	98%	2%
3	Bullgaria	100%	0%	92%	8%
4	Letonia	100%	0%	73%	27%
5	Polonia	93%	7%	93%	7%
6	Republika Çeke	-	-	88%	13%
7	Serbia	95%	5%	89%	11%
8	Hungaria	88%	12%	79%	21%
9	Rumania	-	-	85%	15%
10	Sllovakia	79%	21%	79%	21%
11	Sllovenia	85%	15%	85%	15%
12	Kosova	82%	18%	85%	15%
13	Bosnja dhe Hercegovina	84%	16%	84%	16%
14	Kroacia	84%	16%	84%	16%
15	Maqedonia e Veriut	69%	31%	69%	31%
16	Shqipëria	70%	30%	70%	30%

5. Atraktiviteti i lokacionit

Në total 16 vende të Evropës së Mesme dhe Lindore vlerësohen në këtë anketë.

Pyetjes "Sa tërheqës është vendi si një vend investimi" mund të përgjigjemi në një shkallë nga 1 në 6:

1 = shumë tërheqës ... 6 = jo tërheqës

» Vlerësimi mesatar i një vendi është mesatarja aritmetike e rezultateve në të 16 vendeve pjesëmarrëse në anketim.

Kompanitë pjesëmarrëse nga vendi përkatës mund ta vetëvlerësojnë vendin ku kanë investuar si "Vetëvlerësimi" duke u përgjigjur me 1 = shumë tërheqës ... 6 = jo tërheqës.

Sipas kësaj që po shihet në tabelën si më poshtë, të tjerët Kosovën e vlerësojnë me notën 4.55 dhe renditemi në vendin e 16 nga gjithsej 16 vende.

Më lartë u theksua se 85% do të investonin prapë në Kosovë, ku kjo shërben si indikacion se në Kosovë klima e të bërit biznes është e mirë – ndërsa tabelat më poshtë pasqyrojnë perceptimin që kanë kompanitë e këtyre vendeve për Kosovën dhe rezultojnë që Kosova nuk ka imazh të mirë. German Economic Team në bashkëpunim me OEGJK dhe Rex Consulting gjatë vitit 2022 kanë përgatitur raportin "Përmirësimi i klimës së biznesit – Rritja e investimeve", me ç'rast ky raport ofron propozime për masat afatshkurtra dhe afatgjata të politikave.

Propozimet për masat afatshkurtra të politikave

- » Rritja e efikasitetit në rimbursimin e TVSH-së
- » Lehtësimi dhe nxitja e instalimit të paneleve diellore
- » Përsheptimi i zbatimit të reformave për mbrojtjen e të dhënave
- » Lehtësimi i transportit të mallrave nëpërmjet polisave të sigurimit

Propozimet për masat afatgjata të politikave

- » Reformimi i sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional
- » Sigurimi i infrastrukturës së qëndrueshme
- » Krijimi i një historiku pozitiv të projekteve të suksesshme investive që ndihmojnë në transformim dhe zhvillim digjital

Raport i anketimit për klimën e biznesit dhe investimeve në Kosovë 2023


Umfrageland	AL	BA	BG	CZ	EE	HR	HU	KS	LT	LV	MK	PL	RO	RS	SI	SK
AL	x	3.75	3.50	3.53	3.63	2.60	3.47	3.23	3.43	3.79	3.12	3.38	3.00	3.05	3.29	3.86
BA	3.79	x	3.32	2.83	3.26	3.29	3.18	4.18	3.33	3.27	3.68	3.08	3.20	3.50	3.05	2.97
BG	3.90	3.71	x	2.71	2.85	2.51	3.67	4.00	2.72	2.74	3.98	2.73	2.49	3.40	2.77	2.63
CZ	4.73	4.64	3.85	x	2.64	2.95	3.73	4.98	2.80	2.77	4.30	2.72	3.29	4.07	2.81	2.64
EE	4.14	4.00	3.57	2.89	x	2.82	3.75	4.35	2.41	2.38	3.91	2.45	3.35	4.04	3.08	3.12
HR	4.31	3.91	3.68	2.94	3.20	x	3.72	4.57	3.72	3.64	3.98	3.30	3.69	3.96	2.86	3.07
HU	4.75	4.47	3.87	2.60	2.85	2.91	x	4.70	3.15	3.10	4.01	2.64	3.01	3.58	2.72	2.57
KS	3.37	4.19	3.76	3.59	3.49	3.12	3.56	x	3.74	3.57	3.20	3.28	3.78	4.32	3.03	3.49
LT	4.33	4.27	3.58	2.24	1.64	2.40	3.97	4.50	x	1.97	3.36	1.41	2.70	4.26	2.71	2.55
LV	4.00	4.33	3.53	2.30	1.66	2.41	4.37	4.33	2.15	x	4.00	2.14	3.42	4.06	2.72	2.94
MK	3.93	4.19	3.57	3.35	3.53	3.25	3.09	4.67	3.67	3.67	x	3.19	3.13	2.84	3.28	3.52
PL	4.59	4.40	3.59	2.40	2.69	2.88	3.64	4.89	2.68	2.70	4.23	x	2.97	3.79	2.71	2.48
RO	4.33	4.41	3.42	3.05	2.96	2.95	3.65	4.87	2.98	3.02	3.88	2.88	x	3.71	3.00	3.12
RS	3.94	4.08	3.86	2.91	3.16	3.40	2.97	4.78	3.22	3.17	3.62	3.00	3.00	x	2.52	2.75
SI	5.94	5.40	5.47	5.00	5.33	5.50	5.43	5.70	5.33	5.33	5.50	5.00	5.25	5.57	x	5.25
SK																x
MOE	4.29	4.27	3.75	3.02	3.06	3.07	3.73	4.55	3.24	3.22	3.91	2.94	3.31	3.87	2.90	3.13
Rang	15	14	11	3	4	5	10	16	8	7	13	2	9	12	1	6

6. Lufta në Ukrainë


Në periudhën kur është kryer anketimi, 12% e kompanive të anketuara theksuan se presin t'i kthehen normalitetit në 6 mujorin e parë të vitit 2023; 20% e kompanive të anketuara gjatë vitit 2023; 31% e kompanive të anketuara në vitin 2024; 8% e kompanive të anketuara vlerësojnë se nuk do t'i kthehen normalitetit asnjëherë dhe 29% e kompanive të anketuara nuk kanë dhënë përgjigje.

Efektet e luftës në Ukrainë kanë patur ndikim negativ te kompanitë në Kosovë dhe ky raport trajton edhe këtë aspekt ku janë parashtruar dy pyetje për kompanitë, si në vijim:


Kur pritet normalizimi i zinxhirit ndërkombëtar të furnizimit?



Cilat janë pasojat afatshkurta ekonomike?



Cilat janë pasojat afatgjata ekonomike?



SHTOJCA

A. Pyetjet

- 1.1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale të ekonomisë në shtetin tuaj?
mirë / kënaqshëm / keq
- 1.2. Si e vlerësoni perspektivën e ekonomisë së Kosovës në vitin vijues, krahasuar me vitinparaprak?
më mirë/ pandryshueshëm/ keq
- 1.3. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në industrinë tuaj?
mirë / kënaqshëm / keq
- 1.4. Si do të zhvillohet gjendja në industrinë tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitinparaprak?
më mirë/ pandryshueshëm/ keq
- 1.5. Si e vlerësoni gjendjen aktuale ekonomike të ndërmarrjes tuaj?
mirë / kënaqshëm / keq
- 1.6. Si do të zhvillohet gjendja ekonomike e ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues, krahasuar me vitin paraprak?
më mirë/ pandryshueshëm/ keq
- 1.7. Si do të zhvillohet qarkullimi i ndërmarrjes tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?
më shumë / pandryshueshëm / më pak
- 1.8. Si do të zhvillohet eksporti i ndërmarrjes tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?
më shumë / pandryshueshëm / më pak
- 1.9. Si do zhvillohet numri i të punësuarve në ndërmarrjen tuaj në vitin vijues, krahasuar me vitin paraprak?
më shumë / pandryshueshëm / më pak
- 1.10. Si do të zhvillohen shpenzimet investive të ndërmarrjes tuaj gjatë vitit vijues, krahasuar me vitin paraprak?
më shumë / pandryshueshëm / më pak

2. Sa për qind pritet të rriten shpenzimet tuaja të pagave gjatë këtij viti (në bazë të secilit punëtor, duke marrë parasysh lehtësimet qeveritare)?

Në përqindje (Ju lutem jepni një numër të plotë - pa shifrën dhjetore, pa shenjën e përqindjes)

3. Sa të kënaqur jeni me faktorët e lokacionit?

Shumë i/e kënaqun Shumë i/e pakënaqun 1 2 3 4 5

3.1 Anëtarësia në BE	3.12 Kushtet për hulumtim dhe zhvillim
3.2 Administrata publike	3.13 Disponueshmëria dhe cilësia e furnitorëve vendor
3.3 Ngarkesa tatimore	3.14 Disiplina e pagesave
3.4 Sistemi tatimor dhe institucionet tatimore	3.15 Kostot e punës
3.5 Qasje në subvencione publike	3.16 Përkushtimi dhe produktiviteti i punëmarrësve
3.6 Infrastruktura (trafiku, komunikimi, energjia)	3.17 Kualifikimi i punëmarrësve
3.7 Siguria ligjore	3.18 Cilësia e kualifikimit akademik
3.8 Transparenca e tenderimit publik	3.19 Cilësia e sistemit të aftësisë profesionale
3.9 Parashikueshmëria e politikës ekonomike	3.20 Fleksibiliteti i ligjit të punës
3.10 Luftimi i korrupsionit dhe kriminalitetit	3.21 Disponueshmëria e punonjësve të kualifikuar
3.11 Stabiliteti politik dhe social	

4. Çfarë ndikimi kanë subvencionet e BE-së për vendimmarrjen rreth investimit tuaj?

janë vendimtare
ndikojnë shumë
ndikojnë pak
nuk janë relevante
përfitojnë nga subvencionet

5. Si e vlerësoni në përgjithësi punën e qeverisë aktuale?

mirë
kënaqshëm
keq
Pa përgjigje

6.1. A do ta zgjedhnit sërish Kosovën e tanishëm si vend për të investuar?

Po / Jo

6.2. Nëse jo: Cilat janë regjionet e mundshme të zhvendosjes?

Ju lutem përmendni emrin e regjionit:

7. Sa tërheqës janë vendet e përmendura si vendndodhje investimesh?

AL: Shqipëria
BA: Bosnje dhe Hercegovinë
BG: Bullgari
BY: Bjellorusia
CG: Mali i Zi
CN: Kina
CZ: Republika Çeke
EE: Estonia
HR: Kroacia
HU: Hungaria
KS: Kosovë
LT: Lituania
LV: Letonia
MK: Maqedonia e Veriut
PL: Polonia
RO: Rumania
RS: Serbia
RU: Rusia
SI: Sllovenia
SK: Sllovakia
UA: Ukraina

8. Ku i shihni rreziqet më të mëdha në zhvillimin ekonomik të kompanisë tuaj nëdymbëdhjetë muajt e ardhshëm? (Përgjigje të shumëfishta)

Kërkesa e
tregut
Financimi
Kostot e
punës
Mungesa e punëtorëve të kualifikuar
Norma e këmbimit
Çmimet e energjisë
Çmimet e lëndës së parë
Siguri ligjore
Kudri i politikave ekonomike
Infrastruktura
Pengesat tregtare / preferencë për kompanitë vendase

9. Cilat masa keni ndërmarrë ose planifikoni të ndërmerrni në të ardhmen për të lehtësuar pasojat e mungesës së specialistëve të kualifikuar?

Përdorimi i fuqisë punëtore të përkohshme të rritur
Zgjerimi i zonës së rekrutimit për punonjësit (p.sh. duke ofruar transport)
Rekrutimi i specialistëve të kualifikuar nga jashtë vendit
Motivimi i punonjësve në moshën e pensionimit për të qëndruar në kompani

Zhvillimi i trajnimeve të brendshme të kompanisë
Bashkëpunim i thelluar me institucione arsimore
Rritje e pagave mbi mesataren e tregut
Zgjerimi i shërbimeve shtesë të pagave të vullnetshme (fringe benefits)

Automatizimi i fuqishëm, digitalizimi

Zhvendosja e vendit të punës

Të tjera:

10. Kur e mendoni se do t'i kthehet normaliteti ndërmarrjes tuaj?

rreth 6 muaj

në vitin 2023

në vitin 2024

asnjëherë

asnjë tregues

11. A e planifikon ndërmarrja e juaj / grupi i ndërmarrjeve tuaja diversifikimin e furnitorëve?

Shumë e mundur /E mundur/ e pa mundur/ Pa përgjigje

11.B. Nëse po: Cilat janë regjionet e mundshme?

Gjermania

BE – Evropa Perëndimore

BE – Evropa Lindore

Evropa (jo BE)

Afrika

Azia

Amerika Veriore

Amerika Jugore

B. Metodika

Mënyra e anketimit:

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare që nga viti 2014 merr pjesë në anketimin e përvitshëm të Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK) dhe zhvillon një sondazh me anëtarët e saj

Online nëpërmes një platforme të përbashkët të të gjitha 16 shteteve

Përgjigjet janë anonime

Periudha e anketës:

Në vitin 2023, anketimi u zhvillua nga data 13 Shkurt – 17 Mars 2023

Pyetjet

Pyetjet e parashtruara gjatë anketimit, mund t'i gjeni në shtojcë

C. Pjesëmarrësit

Anketa në Kosovë:

Në anketën e zhvilluar në Kosovë kanë marrë pjesë 103 udhëheqës të kompanive.

Anketa ndërkombëtare:

Përmes Dhomave Gjermane të Tregtisë me Jashtë që nga viti 2006 zhvillohet anketa vjetore për të vlerësuar klimën e të bërit biznes dhe të investimeve në vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore. Në vitin 2023 anketa u zhvillua në 16 shtete.

Në anketën ndërkombëtare morën pjesë 1620 udhëheqës të kompanive.

AL	Shqipëria	44
BA	Bosnja dhe Hercegovina	70
BG	Bullgaria	83
CZ	Çekia	137
EE	Estonia	41
HR	Kroacia	140
HU	Hungaria	249
KS	Kosova	103
LT	Lituania	48
LV	Letonia	50
MK	Maqedonia e Veriut	45
PL	Polonia	220
RO	Rumania	132
RS	Serbia	120
SI	Slovenia	68
SK	Slovakia	70
EML	Gjithsej	1620

D. SHKURTESAT

Shkurtime të vendit korrespondojnë me kodin zyrtar të vendit për tregtinë e jashtme të Komisionit Evropian (Rregullore 1833/2006 i 13.12.2006).

NM-11	Vendet e reja anëtare të BE (2004/2007/2013, përjashtuar Maltën dhe Qipro)	HR	Kroacia
		HU	Hungaria
		KS	Kosova
EU-15	Vendet anëtare të BE deri në zgjerim në 2004	LT	Lituania
		LV	Letonia
AL	Shqipëria	MK	Maqedonia e Veriut
BA	Bosnja dhe Hercegovina	PL	Polonia
BG	Bullgaria	RO	Rumania
BY	Bjellorusia	RS	Serbia
CG	Mali i zi	RU	Rusia
CN	Kina	SI	Sllovenia
CZ	Çekia	SK	Sllovakia
EE	Estonia	UA	Ukraina



KDWV-OEGJK
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

Raport i anketimit për klimën e biznesit dhe investimeve në Kosovë 2023

Rezultatet e sondazhit të 9. të OEGJK

Tel: +383 38 600 880

Adresa: Rr.Bekim Fehmiu 110, Icon Tower, kati 9
Prishtinë/Kosovë

www.oegjk.org